

VENDIM
Nr. 131, datë 16.8.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“THE BLUE STAR” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-I “GORICË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.747 MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “The Blue Star” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat , “b”, “c”, “e”, “f”) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar tërësisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “a” (akti i themelimit të shoqërisë);
- Neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga gjykata);
- Neni 9, pika 2, germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Goricë”, me fuqi të instaluar 1.747 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti